

V E N D I M
Nr.116, datë 18.3.1999

PËR REZERVËN E SIGURISË SË NAFTËS, GAZIT E NËNPRODUKTEVE TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të nenit 9 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kategoritë e naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre, për të cilat do të mbahet rezervë sigurie, janë si vijon:

- Kategoria 0Naftë bruto
- Kategoria IGaz i lëngshëm
- Kategoria IIBenzinë automjetesh
- Kategoria IIIGazoil (Diezel)
- Kategoria IVSolar

2. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, sipas përcaktimeve në pikën 1, të llogaritë sasinë e rezervës së sigurisë, që duhet të mbahet nga refineritë e naftës dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë, e cila duhet të jetë e barabartë me 30 ditë mesatare shitjeje, mbështetur në të dhënat dhe rezultatet faktike të veprimtarisë së vitit të mëparshëm.

3. Sasia e rezervës së sigurisë për vitin pasardhës përcaktohet në fund të tremujorit të tretë të vitit në vijim.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko